

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E HËNË 3 TETOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Së pari, dua të shpreh falënderimet për qeverinë, për të gjithë angazhimin, mbështetjen, koherencën që ka treguar ndaj qytetarëve një situatë globale aspak e zakonshme! Them “në mbështetje dhe në koherencë” pasi e dimë që kjo situatë e krizës energjetike, e cila ka kapluar të gjithë botën, është edhe në Shqipëri. Shumë nga ju apo nga kolegët e opozitës mendojnë se shtyrja e fashës ishte si presion, por projeksioni që ka bërë qeveria dhe përlllogaritjet deri në detaj kanë treguar që koha e aplikimit (për fashën mbi 800 kilovat të fashës), mund të shtyhet.

Patjetër që buletinet dhe institutet meteorologjike kanë pjesën e vet, por nuk mund të parashikojnë çdo pikë shi që mund të bjerë në kaskadat tona, për të mos përmendur që koha në buletinet meteorologjike të shumë viteve më parë është paraqitur për faqe të zezë. Ndoshta ju, kolegë të opozitës, jeni mësuar që në këto buletine të punësonit njerëz të moshuar, që vuanin nga artriti reumatoid, të cilët parashikimin e kohës e bënin duke u bazuar në dhimbjet e kyçeve apo të gjunjëve, por sot gjërat kanë ndryshuar. Kështu që në këtë fjalën time dua të falënderoj qeverinë për të gjithë mbështetjen që ka dhënë dhe që vazhdon të japë për të gjitha këto familje.

Tani të kthehemi te rendi i ditës. Java që lamë pas ishte Java e Gjelbër, të cilën çdo koleg, që është këtu në sallë, ua kushton zgjedhësve. Takimet kanë qenë të shumta me grupet e interesit, me qytetarët, me profesionistët dhe me biznesmenët. Në fakt, duhet të bëhemi pak selektivë dhe të adresojmë problematika të cilat prekin më shumë se një grup interesi, sepse edhe minutazhi që kemi në dispozicion nuk është i mjaftueshëm. Po ju sjell në vëmendje kërkesën e shtuar të disa bizneseve, e cila shkon në sinkron me shumë institucione dhe me shumë

qytetarë, që besoj se ka një mekanizëm, që duhet ta gjejmë të gjithë, madje dhe kolegët ministra, e kam fjalën për tregun e punës dhe krijimin e profesionistëve dhe zanatçinjve.

Është bërë mjaft për këshillimin e karrierës dhe delegimin që u është bërë qendrave të formimit profesional apo shkollave profesionale. Patjetër, duhet bërë akoma më shumë, pasi kapacitetet janë, janë investuar në laboratorë të formimit profesional nga ku mund të dalin kursantë, të cilët mund të mbushin vakuumin për kërkesën e shtuar të profesionistëve apo të zanatçinjve të bizneseve të ndryshme. Fatmirësisht, sot kemi biznese që prodhojnë, tregtojnë dhe eksportojnë në vendin tonë dhe kanë të gjithë klimën e duhur për të konkurruar me vendet e rajonit apo me vendet e BE-së, pasi kapacitetet e tyre prodhuese janë të njëjta me ato të BE-së. Cila është detyra jonë?

Detyra jonë është t'u krijojmë klimën e duhur, duke marrë një mekanizëm që të funksionojë ndërmjet zyrave të punës, qendrave të formimit profesional apo shkollave profesionale, për të krijuar profesionistë dhe zanatçinj, të cilët mund të mbushin vakumet, që mund të kenë këto biznese. Në të njëjtën kohë, shumë kolegë në këtë sallë e dinë që një kërkesë e shtuar e të gjithë qytetarëve është punësimi dhe, nga ana tjetër, ka biznese që kërkojnë profesionistë dhe zanatçinj. Atëherë na lind detyra që të mbështesim zyrat e punës dhe qendrat e formimit profesional për të krijuar sa më shumë profesionistë dhe zanatçinj. Duke pasur besim të plotë tek ekspertiza dhe eksperiencia e Ministrisë së Financave, besoj se kjo gjë do të realizohet.

Doja gjithashtu të sillja një kërkesë të shtruar shpeshherë nga kolegët e opozitës, por edhe të maxhorancës nëpër komisione, që thonë se, ti Florenc, si deputet, kur vjen fjala për vitin shkollor, ke një çështje shumë serioze për të ngritur kryesisht për një target-grup të shtuar të fëmijëve të moshës 10-15 vjeç, që shumë prej jush mund ta kenë prekur tek të afërmit, por edhe te fëmijët tuaj. E kam fjalën për deformimet e kolonës. Kemi bërë shumë punë të mira, është për t'u përgëzuar Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për shkollat që ka gjetur në të gjithë Shqipërinë nga Veriu në Jug por edhe për shtimin e stafeve psikosociale. Mendoj se ka ardhur koha që edhe për deformimet e kolonës apo për kifo skoliozat, ne të bëjmë depistim, vlerësim dhe informim. Faleminderit!